



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2023

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

19.04.2023

Drejtuar: “SI.SI-AL” shpk me NUIS K72117030P me adresë Autostrada Tiranë-Durrës, km.4, 1051 Tiranë,

Procedura e prokurimit: E hapur, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 mujor

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-59352-02-16-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:“Sinjalistikë horizontale (kangjella,birila, grerëza)” me fond limit: 23,087,800 (njëzet e tre milion e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind) Lekë, pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.17, datë.20.02.2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “SI.SI-AL” shpk me NUIS K72117030P, me adresë Autostrada Tiranë-Durrës, km.4, 1051 Tiranë dhe me vlerë të ofruar prej 21.690.500 (njëzet e një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

2. **“NDREGJONI” shpk** me NUIS K31329048I, me adresë Autostrada Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 8, Rruga Sule Bega, Ndertesa Nr. 32, Hyrja 8 dhe me vlerë të ofruar prej 22.649.500 (njëzet e dy milion e gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. **“NDREGJONI” shpk** me NUIS K31329048I, me adresë Autostrada Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 8, Rruga Sule Bega, Ndertesa Nr. 32, Hyrja 8 dhe me vlerë të ofruar prej 22.649.500 (njëzet e dy milion e gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

Nuk ploteson kriterin 2.3.2 "Autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi. Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.", duke qene se nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi.

Nuk ploteson kriterin 2.3.3 "Për mallrat objekt prokurimi, katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.", duke qene se nuk ka paraqitur katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit.

Nuk ploteson kriterin 2.3.4 "Në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, nga 1 (një) mostër për të gjithë mallrat objekt prokurimi (referoju listës në shtojcën 6), nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit. Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.", duke qene se nuk ka paraqitur nga 1 (një) mostër për të gjithë mallrat objekt prokurimi.

Nuk ploteson kriterin 2.3.5 "Deklaratë Garancie jo më pak se 1 (një) vit për mallrat objekt prokurimi. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).", duke qene se nuk ka paraqitur deklaratë Garancie jo më pak se 1 (një) vit për mallrat objekt prokurimi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si të suksesshëm:

1. **“SI.SI-AL” shpk** me NUIS K72117030P, me vlerë të ofruar prej 21.690.500 (njëzet e një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, me adresë në rrugën “5 maji”, Tiranë brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO X

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR